Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Drejtësisë

Departamenti i të Drejtës Penale

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE

JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: E Drejtë Penale

"Dhuna ndaj grave, një analizë Juridiko-Penale dhe aspektet Fenomenologjike"

Punoi: Eler Valishti

Master Profesional Penal, viti i 2

Tiranë 2021

Përmbajtja e punimit **Faqe**

I. HYRJE ……....1

KAPITULLI I

VËSHTRIM HISTORIK DHE JURIDIK I DHUNËS NDAJ GRAVE

1. Dhuna ndaj grave sipas së drejtës zakonore shqiptare.....2

2. Dhuna ndaj grave gjatë periudhës së luftës.....4

KAPITULLI II

VËSHTRIM ANALITIK DHE KRIMINOLOGJIK TË DHUNËS NDAJ GRAVE

1. Jurisprudenca shqiptare lidhur me dhunën ndaj grave.....6

2. Faktorët kriminogjen të dhunës ndaj grave.....8

3. Aspekte fenomenologjike të autorëve e dhunës ndaj grave.....9

KAPITULLI III

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Përfundime dhe Rekomandime.....10

2. Bibliografia.....12

I. Hyrje

Dhuna ndaj grave i ka rrënjët e saj në mesjetë, e ndoshta më tej. Kjo dukuri theksohet në shoqëritë patriarkale. Programi i zhvillimit i Kombeve të Bashkuara, ka raportuar rreth situatës në Shqipëri dhe rezulton se një në tre gra kanë përjetuar dhunë fizike ose psikologjike[1].

Në kapitullin e I të këtij punimi, krahas studimit të Dhunës ndaj grave sipas së drejtës zakonore Shqiptare[2], do të bëjmë edhe një studim të gjakmarrjes në lidhje me kohën e luftës në Kosovë dhe në spektrin ndërkombëtar.

Në kapitullin e II-të, të këtij punimi kam zgjedhur të analizoj aspektet kriminogjene, fenomenologjike gjithashtu edhe një studim analitik sipas Kodit Penal bashkëkohor dhe do trajtoj jurisprudencën shqiptare në lidhje me dhunën ndaj grave.

Në kapitullin e III kam vendosur të nxjer përfundime dhe rekomandimet në lidhje me veprat që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave.

Ndalimi i dhunës në familje duhet të jetë pjesë e themelit të demokracisë. Pa këtë parim, nuk mund të thuhet se një shoqëri mbështetet në shtetin e së drejtës. Ky ndalim është një normë *jus cogens* e linjës zakonore ndërkombëtare.[3]

---

[1] Alfter, Brigitte. "*Focus on Women in Albania*." Shtëpia botuese "Gazeta *Off Our Backs"*, vol. 27, no. 5, Maj 1997, fq.10, marrë online, datë 18.09.2021, për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/20835833 .

[2] E drejta zakonore shqiptare është një e drejtë popullore e pashkruar, e transmetuar brez pas brezi nga tradita gojore që ka shërbyer për rregullimin e marrëdhënieve juridike gjatë shekujve në vendin tonë, përkufizim nga kreu VI 'E Drejta Zakonore Shqiptare', *Historia e Shtetit dhe së Drejtës në Shqipëri*, pjesa e dytë, shtëpia botuese "Luarasi", Tiranë, 1997, f. 229

[3]Termi *jus cogens* është përdorur kryesisht për t'iu referuar atyre rregullave ose parimeve të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare që konsiderohen si 'të pakundërshtueshme' në tipare, duke pasur kështu karakter të pacënueshëm.

Kapitulli I.

Vështrim historik dhe juridik i dhunës ndaj grave.

1. Dhuna ndaj grave sipas së drejtës zakonore Shqiptare.

E drejta zakonore ka vepruar në mënyrë të vazhdueshme në vendin tonë që nga kohët e lashta deri në mesin e shek. XX. Para vendosjes së komunizmit, në veri të Shqipërisë vepronte ligji fisnor i bazuar në "Kanun"[4]. Në historinë e së drejtës zakonore, gruaja ishte sa e mbrojtur dhe po aq e rrezikuar. Jo vetëm nga faktori shoqëror por edhe nga vetë normat e Kanunit të Lekë Dukagjinit, i cili shërbente si ligj i kohës. Në strukturën e familjes Shqiptare, e ndjekur nga një rend patriarkal të së drejtës zakonore, vihet në dukje inferioriteti i gruas[5]. Mjafton të shfletojmë faqet e Kanunit dhe mund të gjejmë mjaft lehtë ideologjinë e "Ligjit kanunor" që kishte kundrejtë gruas. Mund të përmendim art. 20 të Kanunit të L.Dukagjinit: "*Kanuja e xen gruen si nij tepricë në shtëpi*"[6]. Kanuni e konsideronte gruan si të tepërt në shtëpi, madje do të shikojmë që edhe në sanksionimin e "marrjes së gjakut", çmimi i gjakut të gruas nuk bën as sa gjysma e gjakut të burrit[7]. Specifikisht në Kanunin e Lekë Dukagjinit gjaku i gruas ishte e barabartë me vlerën e 1500 grosh. Në të drejtën zakonore kishte një diskriminim të gruas ose më saktë të individit në përgjithësi. Në rreshtat e kanunit gruaja ishte e barabartë sa një send. Ajo nuk gëzonte të drejtën e zgjedhjes në kuadrin familjar as të drejtën e divorcit. Një mbrojtje që gruaja gëzonte në normat

---

[4] de Waal, Clarissa. "*Post-socialist Property Rights and Wrongs in Albania: An Ethnography of Agrarian Change*". Shtëpia botuese "*Ashoka Trust for research in Ecology and the Environment*". Janar - Qershor 2004, fq. 24, marrë online, datë 18.09.2021, për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/26396565 .

[5] Cozzi, D. Ernesto. "*La Donna Albanese: Con Speciale Riguardo al Diritto Consuetudinario Delle Montagne Di Scutari.*" Shtëpia botuese "*Officina di studi medi*evali", 2005. Fq. 63, marrë online, datë 18.09.2021, për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/40443843 .

[6] *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Art. 20 "*Trashigimi i grues Shqyptare*", fq. 13, marrë online date 18.09.2021, për më shumë shih: http://www.vatrarberesh.it/biblioteca/ebooks/kanuni.pdf .

[7] Cozzi, D. Ernesto. "*La Donna Albanese: Con Speciale Riguardo al Diritto Consuetudinario Delle Montagne Di Scutari.*" Shtëpia botuese "*Officina di studi medi*evali", 2005. Fq. 63, marrë online, datë 19 Shtator 2021, për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/40443843 .

Kanunore ishte mbrojtja e saj nga gjakmarrja. Në të drejtën zakonore dhuna ndaj gruas ishte shprehur në një nivel akoma më të zhvilluar se sa në kohët e sotme, duke lënë më nj"anë mënyrat barbare dhe tradicionale të dhunës por duke marrë një karakter më formal dhe të përligjur. Në K.L.D. thuhet se burri ose *gruaja,* të cilët kanë pasur marrëdhënie ilegale, dhe më pas zbulohen dhe kapen, ata pushkatohen nga prindërit e fisit dhe të flamurit, dhe gjaku i tyre qëndron i pashuar[8]. Ndërsa përsa i përketë gruas së ve, e cila zbulohej se pas vdekjes së burrit ishte shtatzënë, digjeshin për së gjalli mbi kashtë ose vendoseshin në mes dy shportave prej druri që digjen, deri sa ata të zbulojnë emrin e "*bashkëpunëtorit*"; nëqoftëse gruaja nuk e zbulonte emrin e tij, ajo mbahej aty deri sa të digjej e tëra në zjarr. Nëse zbulohej emri i "*bashkëpunëtorit*" kapenin të dy dhe pushkatoheshin[9].

Në çdo rast mënyra që gruaja të merrte një pozicion të rndësishëm në nivel juridik duhet të ishte e nevojshme një evoluim konceptesh[10]. Sigurisht, pozita e gruas ka evoluar që nga ajo kohë ku figura e gruas ishte thjeshtë e krahasuar si një objekt e mbushur plot dhe vetëm me detyrime, në ndryshim nga sot, ku grus i jepet mbrojtje juridike, këtë do e analizojmë në kapitujt në vijimë.

---

[8] Cozzi, D. Ernesto. "*La Donna Albanese: Con Speciale Riguardo al Diritto Consuetudinario Delle Montagne Di Scutari.*" Shtëpia botuese "*Officina di studi medi*evali", 2005. Fq. 75, marrë online, datë 19 Shtator 2021, për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/40443843 .
[9] Po aty, për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/40443843 .
[10] Po aty.

2. Dhuna ndaj grave gjatë periudhës së luftës.

Dhuna seksuale kundër grave në periudhat e luftës është një nga çështjet më të mëdha në histori, e shtypur, e cila mbahet në heshtje. Pavarësisht vëmendjes së shtuar në vitet e fundit, tema tenton të anashkalohet dhe të shtyhet në njërën anë. Në fakt, dhuna ndaj grave gjatë luftës tani ka marrë përmasa epidemike dhe bëhet pjesë e brendshme e shumë konflikteve.[11]

Shumë gra dhe vajza kanë qenë pjesë e një dhune të madhe, me përmasa katastrofike gjatë luftës Kosovë-Serbi. Në fillim të Shkurtit e vitit 1998, Policia Serbe dhe paramilitarët e mbështetur nga ushtria Jugosllave nisën një fushatë në rajonin e Drenicës, e cila u bë vatër zjarri ndërmjet lëvizjes së UÇK-së. U vranë 11 fëmijë dhe 23 gra, java vijuese u pasua me 85 viktima të tjerë[12]. Gjatë luftë Kosovë-Serbi pati viktima dhe shumë gra të dhunuara, këtë referoi edhe një grua për gazetën "Balkan Transitional Justice": "Mbaj mend që na kanë mbajtur tri ditë. Ishim 15 veta në një dhomë. Kur jam këndellur e kam parë që syrin e djathtë e kam të lidhur dhe nuk mundesha me lëvizë", kujton ajo. "Halla më tha që nuk duhet të tregoj çka ka ndodhur se më mirë është të mbytesh". Si ajo, mijëra të tjera ishin viktima të dhunës seksuale të përdorur nga forcat serbe gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, e cila me ndihmën e NATO-s i dha fund regjimit të Serbisë. Fata tregon se vendi ku u mbajt ishte bërë qendër e dhunimit dhe vrasjeve nga forcat serbe. "Ditën e parë mbaj mend që dhunimi vazhdoi pa ndërprerë. Ata ndërroheshin ndërsa ne na e fshinin gjakun".[13]

---

[11] Hague, Gill. "*Violence against Women in War and Conflict*". Shtëpia botuese "*Middle East Research Institute*", 2016. Fq. 1. Marrë online date 19.09.2021. Për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/resrep13618 .

[12] Mockaitis, Thomas R. "*Civil-Military Cooperation In Peace Operations: The Case Of Kosovo*". Shtëpia botuese "*Strategic Studies Institute, US Army War College*", 2004. Fq. 6, marrë online datë 19.09.2021. Për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/resrep11291 .

[13] Haxhiaj, Serbeze. "Agonia e Pafund e Grave të Mbijetuara të Dhunës së Luftës në Kosovë", gazeta "Balkan Transitional Justice", publikuar datë 29.05.2017. Marrë online date 19.09.2021, për më shumë shih: https://balkaninsight.com/2017/05/29/ .

Dhuna ndaj grave nuk ishte dhe nuk është fenomen vetëm në pjesën Ballkanike të globit. Ajo është një fenomen shumë i përhapur edhe në vendet e tjera të botës. Në Gusht të vitit 2015, këshilli i sigurimit të OKB-së paralajmeroi se në Irak dhe Siri dhuna seksuale po përdoret si një taktikë e qëllimshme për krime lufte. Statistikat sipas OKB pë disa shtete: [14]

- Në Bosnie dhe Europ, 60,000 femra të përdhunuara gjatë 1992-1995.
- Në Republikën Demokratike të Congo-s, më shumë se 200,000 femra përdhunohen në dekada.
- Nuk mungojnë edhe shumë rastet të tjera dhune, të cilat mbahen të fshehura (Psh.rasti i Myanmar dhe Algjerisë).

Në Qershor të 1993 u mbajt Konferenca Botërore mbi të Drejtat e Njeriut, e cila asistoi në përpjekjen e jashtëzakonshme të arritur nga aktivistët e të drejtave të grave. Konferenca fortifikoi konsensusin politik të dhunës ndaj grave, e cila u ekzaminua në një kontekst më të gjerë të standarteve të drejtave të njeriut në lidhje me diskriminimin gjinor[15]. Njerëzit mund të fitojnë kundër këtyre mizorive edhe pse torturat dhe shkeljet e përjetuara përbëjnë disa nga ngarkimet më shqetësuese kundër njerëzimit. Qëndrueshmëria e grave dhe shpirti njerëzor i tyre do të triumfojnë[16]

---

[14] Hague, Gill. "*Violence against Women in War and Conflict*". Shtëpia botuese "*Middle East Research Institute*", 2016. Fq. 2. Marrë online date 19.09.2021. Për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/resrep13618 .

[15] Sullivan, Donna J. "Women's Human Rights and the 1993 World Conference on Human Rights."Botuar nga "T*he American Journal of International Law*, vol. 88, no. 1, American Society of International Laë, 1994, fq. 152 marrë online në **Jstor** date 19.09.2021. Për më shumë shih: https://doi.org/10.2307/2204032 .

[16] Hague, Gill. "*Violence against Women in War and Conflict*". Shtëpia botuese "*Middle East Research Institute*", 2016. Fq. 3. Marrë online date 19.09.2021. Për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/resrep13618 .

KAPITULLI 2

VËSHTRIM ANALITIK DHE KRIMINOLOGJIK TË DHUNËS NDAJ GRAVE

1. Jurisprudenca shqiptare lidhur me dhunën ndaj grave.

Legjislacioni Shqipëtar, ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore, i cili tashmë është në proces harmonizimi në implementimin e standarteve dhe normave ligjore të Bashkimit Europian[17]. Në vitet e fundit, progres i rëndësishëm është bërë për zhvillimin dhe harmonizimin e legjislacioneve ndërkombëtare për të promovuar mbrojtjen e të drejtave të grave si të drejta bazike të njeriut[18].

Më datë 01.06.2007, ka hyrë në fuqi ligji nr. 9669 "*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*". Krahas këtij ligji kanë dalë shumë ligje të tjera në kuadër të Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të Konventës e Këshillit të Europës dhe shumë akteve të tjera ndërkombëtare, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e grave nga dhuna. Në ligjin e lartëpërmendur në nenin 3/1 të saj shprehimisht thuhet: "Ky ligj bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, *<u>në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave", Konventën e Këshillit të Evropës, "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"</u>* dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë[19].

Politikat e ndërmarra për parandalimin e dhunës ndaj grave nuk është e shprehur vetëm në ligje të veçanta por gjendet e shpërndarë edhe në dispozitat e Kodit Penal, Kodi Familjes e të tjerë. Gjithashtu është bërë i mundur edhe ndërgjegjësimi i organeve ligjvënëse dhe ligjzbatuese në

---

[17] Metani A. dhe Omari S. "On the Road to the EU". "Introduction". Publikuar nga "Open Society Foundations (2006)", fq. 6 Marrë online datë 26.09.2021, për më shumë shih: https://www.jstor.org/stable/resrep34800.4 .
[18] Po aty.
[19] Propozuar nga 20 000 (njëzetëmijë) zgjedhës, Ligji nr. 9669, datë 01.06.2007, "*për masa ndaj dhunës ndaj grave*", Neni 3/1, botuar më datë 01.06.2007, në fletoren zyrtare.

krijimin dhe zbatimin e strategjive të ndryshme për mbrojtjen e grave ndaj dhunës dhe diskriminimit të tyre (Psh. "*Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit*").

Në vitin 2020 janë bërë disa ndryshime të rëndësishme në legjislacionin Shqipëtar. Me Ligjin Nr.35/2020 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, (Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë), të ndryshuar*"[20]. Duke parë nevojën e mbrojtjes së gruas, krahas ndryshimeve që ky ligj ndërmori, në disa dispozita të Kodit Penal u ndryshua edhe neni 130/a "Dhuna në familje" të Kodit Penal, duke shtuar rrethin e objektit dhe të subjekteve të mbrojtura nga rrahja, kanosja serioze për vrasje, plagosjen e kryer me dashje, etj, përsa i përket spektrit familjar. Po në këtë vit kemi ndryshime të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "*Për masa ndaj dhunës në marrëdheniet familjare*", me anë të ligjit Nr. 125/2020 *Për disa shtesa dhe ndryshime*[21]. Përveç ri-specifikimit të dispozitave, duke i dhënë një nuancë më taksative, pas nenit 10 është shtuar neni 10/1 "Rehabilitimi i dhunuesit"[22], kjo dispozitë shërben jo vetëm në integrimin dhe rehabilitimin të autorit të veprës penale në shoqëri por edhe ndërgjegjësimin e tij dhe të shoqërisë për efektet negative që sjellë dhuna ndaj gruas dhe vetë dhuna në përgjithësi, si një politikë për rehabilitim, integrim, ndërgjegjësim dhe për zbatimin dhe pasqyrimin e vlerave që shoqëria jonë mbartë.

Në ndihmë të fortifikimit të jurisprudencës së brendshme Shqiptare, i ka ardhë në ndihmë edhe arena ndërkombëtare me burimet e saj. Shumë thjeshtë mund të përmendim Konventat e ndryshme si ajo e Këshillit të Europës dhe Konventës të Stambollit për parandalimin e dhunës ndaj grave si dhe Raportime të ndryshme si (Raporti i GREVIO-s).

---

[20] Ligji nr.35/2020 *Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar*, Neni 1, f.1.
[21] Ligji nr. 125/2020 *Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" Të ndryshuar*.
[22] Po aty, neni 5, f.2.

2. Faktorët kriminogjen të dhunës ndaj grave.

Në periudhat e pas viteve 1970 në Europën Qendrore dhe pas viteve 1990 në Europën Lindore, me rënien e Komunizmit, organizatat e grave krijuar disa lëvizje për mbrojtjen e tyre, P.sh. këshillimet telefonike dhe ofrimi i shërbimeve të ndryshme për gratë dhe fëmijët, si viktima të dhunës së ushtruar. Organizatat e grave kanë luftuar për të fituar fonde qeveritare për të financuar këto shërbime[23]. U krijua një rrjet të këtyre shërbimëve mbështetëse por në disa shtete dhe rajone këto shërbime patën disa boshllëqe. Problemet ishin sasiore, si pamjaftueshmëria e qëndrave të mbrojtjes së grave dhe fëmijëve dhe kualitative si shërbime jo-specifike.[24]

"*Dhuna Gjinore*"; Ky term i referohet dhunës specifike ndaj grave, e përdorur si instrument për të ruajtur diskriminimin, pabarazinë dhe marrëdhëniet e pushtetit të burrave mbi gratë. Përfshihet dhuna fizike, seksuale dhe psikologjike, duke përfshirë kërcënime, detyrime ose privime të lirisë, etj. Studimet e ndryshme tregojnë se origjina e dhunës është shumëfaktoriale, dmth. ka kushte të ndryshme që kontribuojnë në shfaqjen e saj dhe ato nuk janë gjithmonë të njëjtat. Disa nga shkaqet që janë: Mungesa e kontrollit të impulsit, vetëvlerësimi i ulët, përvojat e përjetuar në fëmijëri, pamundësia për të zgjidhur konfliktet në mënyrë adekuate, Qëndrimet sociokulturore të pabarazisë midis burrave dhe grave, etj.[25]

---

[23] Ravi K. Thiara, Stephanie A. Condon & Schröttle M. "Violence against Women and Ethnicity: Commonalities and Differences across Europe", publikuar nga Verlag Barbara Budrich, 2011, f. 48. Për më shumë shih: https://www.jstor.org/stable/j.ctvbkjë5t.7?seq=1#metadata_info_tab_contents .

[24] Po aty.

[25] Alwang, J., P. Siegel dhe S. L. Jorgensen (2001). *"Vulnerabiliteti: një pamje nga disiplina të ndryshme"*. Banka Botërore. Dokument diskutimi për mbrojtjen sociale. Marrë online datë 16.10.2021. Për më shumë shih: https://sq.warbletoncouncil.org/violencia-intrafamiliar-6629 .

3. Aspekte fenomenologjike të autorëve e dhunës ndaj grave.

Më shumë se gjysma e grave dhe vajzave të moshës 15-74 vjeç kanë përjetuar një ose më shumë nga pesë llojet e dhunës gjatë jetës së tyre, sipas një vrojtimi të kryer nga INSTAT në vitin 2018. Një e treta e grave dhe vajzave, rreth 37 %, kanë përjetuar dhunë gjatë 12 muajve të fundit. Lloji më i zakonshëm i dhunës është dhuna në lidhje dashurie; lloji i dytë më i zakonshëm i dhunës është dhuna nga partneri intim dhe e treta është ngacmimi seksual.[26]

INSTAT; Grafiku; Përjetime dhunës ndaj grave dhe vajzave[27]:



Rreth 41 % e grave kanë përjetuar dhunë për pasojë e xhelozisë dhe rreth 25 % e përjetojnë aktualisht. Rreth 31 % e grave kanë përjetuar dhunë psikologjike dhe rreth 20 % e përjetojnë aktualisht. Rreth 18 % e grave të moshës 18-74 vjeç kanë përjetuar dhunë fizike dhe rreth 7 % aktualisht kanë përvojë të llojeve të ndryshme të dhunës fizike në martesë ose marrëdhënie intime.[28]

---

[26] INSTAT, "*Statistika në shkolla", "Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri".* Marrë online datë 17.10.2022. Për më shumë shih: http://www.instat.gov.al/media/6121/publikimi-dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave.pdf .
[27] Po aty.
[28] Po aty.

KAPITULLI III
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Përfundime dhe Rekomandime.

Mund të themi që ligji dhe strukturat e suportit kanë disa mangësi përsa i përketë mbrojtjes së dhunës ndaj grave. Pjesa më e madhe e masave për mbrojtjen nga dhuna janë adaptuar si nga Kodi Civil ashtu edhe nga Kodi Penal. Padyshim që keto instrumente janë të rëndësishme por nuk janë të mjaftueshme.[29]

Studimet kudo kanë treguar se dhuna nga partneri intim është një prej formave më të përhapura të dhunës të përjetuar nga gratë në shumicën e vendeve në botë. Gjithashtu, është një problem i përhapur gjerësisht në familje dhe komunitete kudo në Shqipëri.[30]

Analizat e dhunës duhet të kalojnë përtej modeleve aktuale që mbështeten në idetë bazë për burrat dhe gratë dhe që injorojnë shumëllojshmërinë e faktorëve që mund ta bëjnë dikë viktimë e dhunës.[31]

---

[29] Ravi K. Thiara, Stephanie A. Condon & Schröttle M., "*Violence against Women and Ethnicity: Commonalities and Differences across Europe*", Publikuar nga: Verlag Barbara Budrich, A. Condon & Schröttle M. (2011). F. 54, Marrë online datë 17.10.2021. Për më shumë shih: https://www.jstor.org/stable/j.ctvbkjë5t.7?seq=1#metadata_info_tab_contents .

[30] INSTAT, "*Statistika në shkolla", "Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri".* Marrë online datë 17.10.2022. Për më shumë shih: http://www.instat.gov.al/media/6121/publikimi-dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave.pdf .

[31] Rosen R & Tëamley K. "Feminism and the Politics of Childhood", publikuar nga UCL Press (2018), marrë online datë 17.10.2021, për më shumë shih: https://www.jstor.org/stable/j.ctt21c4t9k.22 .

2. Bibliografia.

1. Alfter, Brigitte. "*Focus on Women in Albania*." Shtëpia botuese "Gazeta *Off Our Backs"*, vol. 27, no. 5, Maj 1997, marrë online, datë 18.09.2021, për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/20835833
2. Omari L. & Luarasi A. "*Historia e Shtetit dhe së Drejtës në Shqipër*", pjesa e dytë, shtëpia botuese "Luarasi", Tiranë, 1997.
3. de Waal, Clarissa. "*Post-socialist Property Rights and Wrongs in Albania: An Ethnography of Agrarian Change*". Shtëpia botuese "*Ashoka Trust for research in Ecology and the Environment*". Janar - Qershor 2004, marrë online, datë 18.09.2021, për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/26396565
4. Cozzi, D. Ernesto. "*La Donna Albanese: Con Speciale Riguardo al Diritto Consuetudinario Delle Montagne Di Scutari.*" Shtëpia botuese "*Officina di studi medi*evali", 2005. Marrë online, datë 18.09.2021, për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/40443843
5. *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Art. 20 "*Trashigimi i grues Shqyptare*", marrë online date 18.09.2021, për më shumë shih: http://www.vatrarberesh.it/biblioteca/ebooks/kanuni.pdf
6. Hague, Gill. "*Violence against Women in War and Conflict*". Shtëpia botuese "*Middle East Research Institute*", 2016. Marrë online date 19.09.2021. Për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/resrep13618
7. Mockaitis, Thomas R. "*Civil-Military Cooperation In Peace Operations: The Case Of Kosovo*". Shtëpia botuese "*Strategic Studies Institute, US Army War College*", 2004. marrë online datë 19.09.2021. Për më shumë shih: http://www.jstor.org/stable/resrep11291

8. Haxhiaj, Serbeze. “Agonia e Pafund e Grave të Mbijetuara të Dhunës së Luftës në Kosovë”, gazeta “Balkan Transitional Justice”, publikuar datë 29.05.2017. Marrë online date 19.09.2021, për më shumë shih: https://balkaninsight.com/2017/05/29/

9. Sullivan, Donna J. “Women’s Human Rights and the 1993 World Conference on Human Rights.”Botuar nga “T*he American Journal of International Laë*, vol. 88, no. 1, American Society of International Law, 1994, marrë online në **Jstor** date 19.09.2021. Për më shumë shih: https://doi.org/10.2307/2204032

10. Metani A. dhe Omari S. “*On the Road to the EU*”. “Introduction”. Publikuar nga “Open Society Foundations (2006)”, marrë online datë 26.09.2021, për më shumë shih: https://www.jstor.org/stable/resrep34800.4

11. Propozuar nga 20 000 (njëzetëmijë) zgjedhës, Ligji nr. 9669, datë 01.06.2007, “*për masa ndaj dhunës ndaj grave*”, botuar më datë 01.06.2007, në fletoren zyrtare.

12. Ligji nr.35/2020 *Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar*.

13. Ravi K. Thiara, Stephanie A. Condon & Schröttle M. “Violence against Women and Ethnicity: Commonalities and Differences across Europe”, publikuar nga Verlag Barbara Budrich, 2011. Për më shumë shih: https://www.jstor.org/stable/j.ctvbkjë5t.7?seq=1#metadata_info_tab_contents

14. Alwang, J., P. Siegel dhe S. L. Jorgensen (2001). *"Vulnerabiliteti: një pamje nga disiplina të ndryshme"*. Banka Botërore. Dokument diskutimi për mbrojtjen sociale. Marrë online datë 16.10.2021. Për më shumë shih: https://sq.warbletoncouncil.org/violencia-intrafamiliar-6629

15. INSTAT, "*Statistika në shkolla", "Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri".* Marrë online datë 17.10.2022. Për më shumë shih: http://www.instat.gov.al/media/6121/publikimi-dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave.pdf

16. Rosen R & Tëamley K. "Feminism and the Politics of Childhood", publikuar nga "UCL Press" (2018), marrë online datë 17.10.2021, për më shumë shih: https://www.jstor.org/stable/j.ctt21c4t9k.22